



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1784/12 Prot.

Durrës më, 15/12/2021

V E N D I M

Nr. 86 Datë 15/12 2021

"PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË REKRUTIMIT ME KOHË TË PJESSHME TË NJË STUDENTI TË CIKLIT TË DYTË, PRANË FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT PËR MIRMBAJTJEN DHE ZHVILLIMIN E FAQES ZYRTARE TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685 datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Rregullores së Universitetit, të Statutit të Universitetit, të shkresës nr. 1733 prot, datë 07.12.2021 të Rektores së Universitetit, të shkresës nr. 1733/1 datë 09.12.2021 të Drejtorisë Administrimit dhe Shërbimeve Akademike, Senati Akademik

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të rekrutimit me kohë të pjesshme të nje studenti, të ciklit të dytë pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit për mirmbajtjen dhe zhvillimin e faqes zyrtare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Ky vendim i përcillet për shqyrtim Bordit të Administrimit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët.
 - Administratori .
 - Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike.
 - Drejtoria e Burimeve Njerzore dhe Juridike.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1484/4 Prot.

Durrës më, 15/12/2021

V E N D I M

Nr. 88 Datë 15/12 2021

PËR

"HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE DOKTORATË NË "PEDAGOGJI", PRANË DEPARTAMENTIT TË PEDAGOGJISË, NË FAKULTETIN E EDUKIMIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41 "Për elementet e programeve të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar me VKM Nr.879, datë 16.12.2019 "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" në Udhëzimin Nr.01, datë 14.01.2020, "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve Doktoratë në "Pedagogji", pranë Departamentit të Pedagogjisë, në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për shqyrtim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Fakultetit të Edukimit
 - Drejtuesi i Njesisë Bazëtë Departamentit të Pedagogjisë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. *Ksëanela SOTIROFSKI*

